



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare
Ministarstvo za Rad, Porodicu i Vrednosti Oslobodilačkog Borbe
Ministry of Labour, Family and Values of the Liberation War

Në mbështetje të nenit 11, paragrafi 1.1 dhe 1.5 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 9, nenit 10, paragrafi 2 dhe nenit 22 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, nenit 8 të Rregullores (QRK) Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Ministrive, si dhe nenit 5, nenit 6, 8, 23, 24 dhe 25 të Ligjit Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, nenit 2, të Ligjit Nr. 2002/9 për inspektoratin e punës në Kosovë, i Ministrisë për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare, me datë 13.04.2026 nxjerr këtë:

V E N D I M

Neni 1

Ky vendim ka për qëllim ndërmarrjen e masave të menjëhershme dhe emergjente për rritjen e nivelit të sigurisë dhe shëndetit në punë, me fokus të veçantë në sektorin më rrezikshmëri të lartë.

Neni 2

Urdhërohet Inspektorati Qendror i Punës të hartoj planin emergjent për fillimin e menjëhershëm të një aksioni të jashtëzakonshëm kombëtar të inspektimeve;
Aksioni zbatohet në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës, me fokus në kantieret ndërtimore dhe aktivitetet me rrezik të lartë, në afat kohor prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh.
Inspektimet realizohen në mënyrë intensive, përfshirë ditët e festave dhe jashtë orarit të rregullt të punës.

Neni 3

Çdo subjekt që konstatohet se nuk respekton masat bazike të sigurisë dhe shëndetit në punë:

I ndalohet menjëherë aktiviteti duke iu vendosur shenjat (shiritat) apo blloibat bllokuese nga IQP;

I shqiptohen masat ndëshkuese sipas legjislacionit në fuqi;

Inicohet procedura për pezullim të përkohshëm të veprimtarisë dhe masa të tjera ligjore, deri në zbatimin e masave të rekomanduara;

Ndalimi i aktivitetit bëhet në vend, pa paralajmërim paraprak, në rastet kur rrezikohet jeta e punëtorëve.

Neni 4

Inspektorati Qendror i Punës obligohet të organizojë punën në terren me dy ndërrime të përditshme, me qëllim rritjen e prezencës dhe mbulimit efektiv gjatë gjithë ditës.

Orari i inspektimeve bëhet me plan operativ emergjent të Inspektoratit.

Prania në terren është e detyrueshme edhe gjatë ditëve të festave, në përputhje me planin e organizimit të ndërrimeve.

Neni 5

Urdhërohet rrotacion i detyrueshëm i inspektorëve të punës ndërmjet komunave dhe rajoneve, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe shmangien e konfliktit të interesit.

Inspektorati i Punës harton dhe zbaton menjëherë planin e rrotacionit për gjithë periudhën e aksionit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Çdo refuzim ose shmangie nga rrotacioni trajtohet si shkelje disiplinore.

Neni 6

Formohet një Task-Forcë e përkohshme ndërinstytucionale për sigurinë dhe shëndetin në punë në sektorin e ndërtimtarisë.

Task-Forca përbëhet nga përfaqësues të Inspektoratit të Punës, Policisë së Kosovës dhe institucioneve relevante.

Detyrë e Task-Forces është koordinimi i veprimeve në terren dhe mbështetja në zbatimin e masave ndëshkuese.

Neni 7

Krijohet një ekip ad hoc vlerësues, me mandat të përkohshëm, për analizimin e rasteve të fundit të aksidenteve në punë.

Ekipi ka për detyrë:

Analizimin e rastit më të fundit;

Analizimin e të gjitha rasteve të ndodhura gjatë dymbëdhjetë (12) muajve të fundit;

Identifikimin e shkaqeve të aksidenteve, ndërmarrja e veprimeve nga inspektorati, dhe zbatimi i masave nga punëdhënësit;

Dhënien e rekomandimeve konkrete për masa parandaluese dhe përmirësim të sistemit të inspektimit.

Ekipi përbëhet nga përfaqësues të ministrisë dhe ekspertë të fushës.

Ekipi obligohet që brenda 1 (një) muaji të dorëzojë raportin përfundimtar me gjetje dhe rekomandime.

Neni 8

Inspektorati i Punës obligohet të publikojë çdo 48 orë:

Numrin e inspektimeve të realizuara;

Numrin e ndalimeve të aktiviteteve;

Numrin e masave ndëshkuese të shqiptuara.

Të dhënat publikohen në faqen zyrtare të Inspektoratit dhe rrjetet sociale, për qëllime transparence dhe informimi të qytetarëve.

Neni 9

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Andin HOTI



Ministër

Vendimi i dërgohet:

- Inspektoratit Qendror të Punës;
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë;
- Arkivit të Ministrisë;